



Dalës-Izlaçna

Nr. -1-196
Br.

Data 18.11.2019
Datum

ORILLIO-DRILLIO



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 te Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI²⁷, mbledhja e 12) me dt..25.11.2019 (e hënë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive "Adem Jashari", objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq
4. Shyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e draft planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022
5. Shqyrtimi i draft Statutit të Komunës së Obiliqit
6. Raporti i Komisionit komunal sipas vendimit :Nr.I-170
 - a. Raporti me nr. X-1054 te datës 04.11.2019
 - b. Raporti me nr X-1087 të datës 11.11.2019
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



Dalës-Izazna

Nr. -1-195
Br.

Data 18.11.2019
Datum

OBILIQ-OBLIC



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.10.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Muhamet Mustafa (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlija (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma) Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjera: Ibush Mjekiqi, Nënkyrytar i Komunës, drejtoret komunal, drejtori i QKMF-së, Rifadije Paloja, udhëheqëse e sektorit për kulturë, përf. i IZHL-së, përf.i KDI-së dhe përf.i USAID-it

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për administrimin e Shtëpive të kulturës në Komunën e Obiliqit
4. Shqyrtimi i raportit finanziar 9 mujor (DEFZH)
5. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e Draft Strategjisë për zhvillimin e turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore/natyrore 2019-2023
6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelat Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin
7. Shqyrtimi i vendimeve të Kuvendit komunal sipas kërkesave të MAPL-së
 - a) Kërkesa nr.-VI-020-948/9 të dt.03.10.2019
 - b) Kërkesa nr.-VI-0201023/7, të dt.11.10.2019
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesi - I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Lulzim Sadiku – Paraqet vërejtje dhe kërkoi sqarim pse nuk ka pasë procesverbal.

Aziz Bici – Kërkon sqarim pse nuk ka procesverbal dhe propozoi që pika e 6 e rendit të ditës të hiqet sepse te neni 1, i Propozim vendimit thuhet se shpronësimi i kësaj parcele kërkohet me kërkesën e Drejtorisë së

infrastrukturës për të realizuar projektin kapital me shumë rëndësi të një rruge, që do ti lidhë fshatrat e Qyqavicës me Milloshevën. Mendoj se kur është një projekt aq i rëndësishëm është dashur të zhvillohet debat publik me shoqërinë civile dhe banorët e këtyre fshatrave, e jo të kërkohet menjëherë shpronësimi. Poashtu, ne nuk kemi informacion se është një rrugë aq e rëndësishme duke pasur parasysh gjendjen në të cilën jetojmë sepse në shumë vende mungon uji, kanalizimi etj.

Armend Rushiti – Paraqet vërejtje për arsyen se mungon procesverbali dhe kërkon që mundësish të rregullohet dhe ta kemi atë material në USB. Poashtu, kërkon që kërkesa për banorët e Mazgitit dhe Llazarevës, lidhur me pronën që Komuna ia ka dhënë “Apollonisë” të futet në rend dite.

Kryesuesi – Sa i përket procesverbalit zyrtarja ka qenë në pushim vjetor dhe me këtë çështje është marrë znj. Suzana Hashani, por nuk është hera e parë që ne kemi probleme teknike. Unë ju kërkoj falje sepse të njejtin problem e kemi pasë edhe në KPF.

Armend Rushiti – Kjo kërkesë e këtyre banorëve nga MAPL-ja, kthehet si e paligjshme, ka shumë dëshmi për këtë kontest pronësor dhe një prej tyre është se e kemi materialin komplet të banorëve dhe një CD, për të gjitha punimet që zhvillohen në kuadër të kësaj prone. Ne jo vetëm që këtë pronë si Kuvend komunal ia kemi dhënë në shfrytëzim kompanisë “Apollonia” por aq sa i kemi dhënë edhe aq hapësirë kompania është duke e keqpërdorë dhe për këtë ka mjaft dëshmi. Mendoj se kjo kërkesë patjetër duhet të diskutohet.

Kryesuesi – Ju njoftoj se kërkesa prej atyre banorëve zyrtarisht nuk ka ardhë në adresë të Kuvendit komunal, por mbetet të diskutohet në pikën të ndryshme.

Armend Rushiti – Kjo kërkesë për të cilën kanë bërë petition 50 banorë, ka ardhë me dt.28 gusht, por ju nuk e keni paraqitë në Kuvend dhe ku është problemi te administrata, apo te ju.

Kryesuesi – Sqaron se çdo lëndë që vjen shqyrtohet në KPF, pastaj kalon në Kuvend.

Aziz Bici – Vetëm ta kemi një informacion më të quartë, a është dorëzuar kërkesa në sekretari apo jo.

Kryesuesi – Përgjegjet jo, kërkesa i është drejtuar Zyrës së Kryetarit dhe Drejtoria e infrastrukturës dhe Drejtoria e inspektoriatit e kanë trajtue këtë kërkesë dhe kanë dhënë përgjegje.

Lulzim Sadiku – Propozoj që pika e 2, të hiqet nga rendi i ditës, pasi që nuk ka procesverbal.

Kryesuesi – Pika e dytë e rendit të ditës figuron vetëm për shkak të procedurës dhe aprovohet me vërejtjet tuaja. Ne, i kemi 2 propozime, propozimi i parë që të miratohet rendi i ditës, ashtu qysh e keni marrë ju si material dhe propozimi i dytë ishte i z.Aziz Bici, që pika e 6 e rendit të ditës të hiqet dhe në rend dite të futet kërkesa e z.Armend Rushiti.

Tash e hudhi në votim propozimin e parë të rendit të ditës, ashtu qysh e keni marrë ju me material.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota “Për” 5 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” e miratuan rendin e ditës.

Lulzim Sadiku – Kryesues, nuk është e drejtë të mos më lejosh të votoj dhe të lutem jepi mundësi pozitës dhe opozitës me votue drejtë. Unë dua ta arsyetoj pse kam votue “Për” dhe “Kundër” dhe le të figuroj sa janë “Për” dhe sa janë “Kundër”.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Fatmir Bekteshi me leje.

Pika 2 e rendit të ditës

Lulzim Sadiku – Unë personalisht kam kërkuar që të rritet numri i të punësuarve në administratë dhe kam thënë gjithmonë se ky procesverbal është amateresk dhe kurrë asnjëherë nuk është ndërmarrë diçka që ne kemi kërkuar. Prosesverbali duhet të jetë një procesverbal që të dëshmohet për gjeneratat e ardhshme kush dhe si ka votue. Megjithatë në procesverbal asnjëherë nuk ceket kush si voton, do të thotë shkon blanko dhe gjithmonë e vëni në lajthitet pozitën dhe opozitën. Kërkoj sa i përket procesverbalit që është një dokument zyrtar të jemi më të thukët, që të ruhet dhe të dihet kush si voton dhe si vepron.

Kryesuesi – Ne e kemi Rregulloren e punës nr.1-95, e dt.29.06.2018, e cila e përcakton edhe formën e votimit dhe kur ka raste specifike ne mund të shkojmë me votim të veçantë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota “Për” dhe 2 vota “Kundër” u pajtuan lidhur me ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar që të përfshihen vërejtjet dhe sugjerimet e tyre.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Për një sqarim më detal rreth Draft Rregullores për administrimin e Shtëpive të kulturës në Komunën në Obiliqit, fjalën ia dha znj.Rifadije Paloja, udhëheqëse e sektorit për kulturë.

Rifadije Paloja – Drejtoria jonë, kryesisht sektori i kulturës ka pasë një punë intenzive rreth Rregullores për administrimin e Shtëpive të kulturës. Duke e parë të arsyeshme se ekzistojnë edhe 2 Shtëpi tjera të kulturës në Milloshevë dhe Plemetin, ne i kemi inkorporuar të dyjet dhe kemi dalë me një dokument të vetëm, do të thotë me administrimin e 3 objekteve kulturore ekzistuese në Komunën tonë.Ne jemi konsultuar edhe me sektoret e kulturës të Komunave tjera, që kanë pasë një dokument të tillë dhe e kemi hartuar këtë Draft Rregullore, e cila ndihmon në mbarëvajtjen e veprimitarive të ndryshme.

Lulzim Sadiku– Unë nuk e di se kjo Draft Rregullore ka kalue në dëgjimin publik sepse nuk kam qenë. Për me u realizue kjo Draft Rregullore sipas standardeve në fuqi është dashur të formohet një Komision nga Kuvendi, që në fakt shihet pak më mirë. Unë në emër të grupit të PD, kërkoj që të hiqen të gjitha pagesat për qytetarë dhe stafin sportiv për aktivitetet që janë në Komunën e Obiliqit sepse e dijmë se sporti në vendin tonë tash ka filluar të lulëzon. Kërkoj që Komuna jonë të përfshihet në aktivitetet pa pagesë, që të kemi sportistë dominantë dhe nga Komuna jonë.

Kryesuesi – Sqaron se kjo Draft Rregullore ka kalue 2 herë në dëgjimin publik dhe i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore

Aziz Bici – Thuhet shqyrtimi i Draft Rregullores për administrimin e Shtëpive të kulturës në Komunën e Obiliqit, por kur shkon më poshtë flitet vetëm për Shtëpinë e kulturës “Xhavit Haziri” në Obiliq dhe askund nuk përmendet Shtëpia e kulturës në Milloshevë dhe në Plemetin. Për anëtarësimin e fëmijëve prej klasës së pestë deri në klasën e nëntë për një vit në bibliotekë është 5 €. Ne kërkojmë që të rinjëve fare mos t’iu merren paratë sepse ne duhet ti joshim të rinjët se e dijmë se janë larguar prej leximit dhe duhet disi t’iu krijojmë kushte për me iu afrue leximit, e jo me iu vënë bariera. Në nenin 4, pika 4 dhe 5, është cekë se Shtëpitë e kulturës mund të jepen në shfrytëzim afatshkurtë apo afatgjatë, por nuk është cekë se cilat aktivitete mund të zhvillohen në këto objekte. Poashtu, nuk është cekë sa vite jepet në shfrytëzim për periudhën afatgjatë.

Kryesuesi - Ju njoftoj se në KPF, z.Slavisa Spasic e ka bërë njoftimin se ka kaluar nga grupi SLS në SL.

Slavisa Spasic –Tani e pyes udhëheqësen e sektorit për kulturë se sa e di unë në Plemetin është Qendra rinore, e jo Shtëpia e kulturës.

Nazmi Gashi– Ne nuk e dijmë as gjendjen e objekteve, se a i plotësojnë kriteret me i marrë parat prej qytetarëve, a kanë sistem të ngrohjes dhe të ajrosjes, si dhe qysh është gjendja higjenike dhe e pajisjeve. Mendoj se është mirë që të formohet një Komision nga Kuvendi komunal dhe të verifikohet gjendja reale në mënyrë që ta dijmë saktë gjendjen e këtyre objekteve. Kjo Draft Rregullore nuk e ka përfshirë shumicën e kërkeseve, nuk e ka përfshirë edhe stafin e punëtorëve sepse ne e dijmë se objektet po ndërtohen, por mirëmbajta e tyre po na kushton.

Kryesuesi – E drejta e anëtarit të Kuvendit komunal në qasjen në dokumentet zyrtare dhe në çdo objekt publik është e drejtë e patjetërsueshme. Unë ju ftoj ti viziton objektet publike, të jepni vërejtjet dhe kritikat tuaja, por Draft Rregullorja në fjalë flet për mënyrën e administrimit, e jo për gjendjen faktike.

Aziz Bici – Ju thatë se ne kemi të drejtë në qasjen në dokumentacion dhe ne e dijmë se kemi të drejtë. Mirëpo, ne nuk kemi qasje në dokumentacion dhe ju e dini se unë kam bërë kërkësë për emërtimin e sheshit me ç’rast kam kërkuar të dijmë se kur janë organizuar debatet dhe asnjëherë nuk më është ofruar mundësia për qasje në dokumentacion. Prandaj, sa herë që ju e thoni duhet ta arsyetonit atë, e jo me thënë keni qasje sepse jemi të penguar dhe nuk kemi qasje në dokumentacion.

Kryesuesi – Sqaron se çështja e sheshit është mbyllë me një konsensus të përgjithshëm dhe në të kaluarën është bërë një debat. Unë nuk e di se ka kontratë të papublikuar, ndërsa sa i përket qasjes në objektet publike, unë nuk e di se dikujt iu ka mohue kjo e drejtë deri më sot.

Aziz Bici – Ju nuk mund të thoni e kemi mbyllë derisa nuk jemi marrë vesh sepse unë kam mbetë pa e marrë dokumentin të cilin e kam kërkuar prej arhivës.

Kryesuesi – Është mbyllë sepse është rivotue dhe ju e dini se ka qenë kërkesë specifike e të gjitha grupeve të interesit nga shoqëria civile, nga shoqatat e dalura prej luftës, nga partitë politike dhe e kemi mbyllë çështjen, që është politizue pa nevojë, por më së miri koha do ta tregon.

Aziz Bici – Ju nuk i keni respektue procedurat dhe ju nuk jeni ata që vendosni për emërtime sepse duhen debatet publike dhe ju nuk i keni organizue debatet publike. Ju keni gjetë kompromis në mes veti me partitë politike, që e keni votue së bashku me shoqatat e dalura nga lufta pa debat publik me shoqërinë civile dhe me qytetarët.

Rifadije Paloja – Sa i përket anëtarësimit në bibliotekë, ne jemi mundue me gjetë një mesatare që konsiderojmë se nuk është vlerë e lartë, megjithatë e shqyrtojmë. Mendoj se lexuesi përveç që hyn në bibliotekë dhe shërbhet me libër për të lexuar, ai njëkohësisht duhet me pasë edhe kujdesin për me ruajtë atë libër. Ne ju referohemi padyshim edhe Ligjt për dhënien në shfrytëzim të objekteve kulturore dhe ligji e përcakton kohëzgjatjen prej 3-5 vjet. Lidhur me atë që tha anëtarë i Kuvendit se emërtimi është Qendër rrinore, ne e kemi informacionin se është Shtëpi e kulturës, prandaj dhe e kemi përfshi edhe atë për administrim si objekt kulturor.

Ibush Mjekiqi – Nëse në Draft Rregullore është përmendë vetëm Shtëpia e kulturës “Xhavit Haziri” atëherë duhet të shtohen edhe Shtëpia e kulturës në Baimoc, Plemetin dhe Milloshevë.

Hysni Mjeku – Ne edhe në KPF, kësaj Rregulloreje i kemi dhënë hapësirë me ardhë në Kuvend sepse e plotëson pjesën hyrëse, dispozitat e përgjithshme dhe ato kalimtare. Propozoj që çështja e pagesës fare të mos merret parasysh, do të thotë të lirohen të gjitha aktivitetet kulturore, sportive dhe politike, sidomos politike sepse vetë politika e sjellë edhe kulturën e të tjera. Pra, ne jemi ata që e organizojmë jetën kulturore dhe politike sidomos te çështja e tubimeve të përmbylliave të partive politike, të mos bëjmë asnijë pagesë sepse Shtëpitë e kulturës janë ndërtuar për interesat e shoqërisë tonë lokale. Sa i përket renovimeve, që u potencuan nga disa parafolës janë Rregulloret se si duhet të menaxhohet një objekt i rëndësisë së veçantë. Mendoj se një Rregullore që ka të bëjë me jetën kulturore, sportive dhe politike në Komunën tonë duhet të ketë një hapësirë më të madhe dhe një përkujdesje më të mirë. Në të ardhmen çdo Rregullore që delë nga ky Kuvend paraprakisht duhet ta ketë edhe Komisionin e mandatuar nga Kuvendi, e jo çdo Drejtori të bën Rregullore ashtu qysh atyre ju tekët, pa një përfaqësues të Kuvendit komunal.

Aziz Bici – Askush nuk është kundër Rregullores dhe ne gjithsesi duhet ta kemi Rregulloren, por duhet të jetë sa më e pranueshme dhe sa më efikase. Unë ju kuptova juve kryesues, se në të ardhmen do të rregullohen këto, por këtu po kërkohet miratimi i Rregullores. Prandaj, më mirë është të premtoni se do ti rregullojmë sot këto që u kërkuan prej të gjithëve, por edhe për bibliotekë të mos mbeten për të ardhmen, përndryshe ne do të votojmë “Kundër”.

Nora Preniqi – Propozoj që te neni 14, pika 4, pasi që biblioteka ende nuk është ndërtuar të hyrat nga anëtarësimi i lexuesve të hiqen dhe në ndërkokë le të bashkangjiten për bibliotekën.

Rifadije Paloja – Sqaron se aktualisht janë mbi 5,000 ekzemplarë librash të cilat ndodhen në Palestrën sportive “Adem Jashari”. Për faktin se procedura e inventarizimit të objektit kulturor “Xhavit Haziri” është në procedurë, shumë shpejtë pritet që objekti në tërësi të pajiset me inventarë. Në momentin që pajiset me inventarë, atëherë të gjithë inventarin librar që e kemi në Palestrën “Adem Jashari” ne do ta sjellim këtu dhe mos të pritet derisa të bëhet objekti i bibliotekës. Prandaj, aty do të jetë një mini bibliotekë, që do të funksionoj së shpejti.

Lulzim Sadiku – Unë po e shohë se nuk jemi të përgatitur për këtë Draft Rregullore, ka shumë mangësi, nuk i mora përgjegjet që i kërkova se kur është rekomandue me dalë në dëgjim publik, sa ka pasë anëtarë që ka qenë në dëgjim publik dhe me cilën datë. Pastaj, Komisioni që është formuar për këtë Rregullore, ku është formuar dhe kush e ka punuar, kopjuar apo rekomanduar këtë Rregullore që të vjen këtu. Propozoj që kjo Draft Rregullore të prolongohet për seancën e radhës në mënyrë që ta nxjerim një Rregullore të nivelit që e meriton Komuna e Obiliqit. Qëndrojmë në pikat që i thamë se brenda Rregullores mos të ketë pagesa as për partitë politike, as për lexuesit dhe as për administrues që marrin pjesë për çështje të aktiviteteve në

Komunën tonë.

Kryesuesi – Ju lutem mos bëni politikë sepse kjo Draft Rregullore ka marrë vizë prej anëtarëve të Kuvendit komunal dhe ka dalë në debat publik. Te neni 12, që e përmendi z.Aziz, propozoj të shtohet neni 12.1, 12.2, ndërsa pjesët tjera të mbeten 1,2,3 dhe 4, si dhe të bëhet një shpjegim edhe për Shtëpinë e kulturës në Milloshevë dhe në Plemetin. Te neni 14, pika 2 hiqet në tërësi dhe pika 3, bëhet pika 2, ndërsa të tjerat vazhdojnë. Në faqen nr.8, është lirimi nga pagesa dhe kur jemi te pagesa e partive politike kur hyn Ligji për zgjedhjet në fuqi, këto bien. Unë mund të them se te çështja e pagesave nuk mund të shkojmë me 0, sepse janë Udhëzimet administrative që nuk na lejojnë dhe është auditori i brendshëm dhe general, që ne vazhdimisht marrim vërejtje për mospagesë.

Lulzim Sadiku – Unë nuk e kupto se me çfarë politike merret një anëtar i Kuvendit komunal, që pyet kur është formuar Komisioni, kur është rekomanduar nga Kuvendi dhe ku janë mbajtë dëgjimet publike. Ju thoni është çështje politike dhe unë s'po e kupto për qfarë politike po flet sepse ne ishim duke folë për një Rregullore, që është e drejtë e imja të pyes saktë. Ne folëm për pikën 2, të rendit të ditës pa ekzistue fare, tash konkretisht po flasim për bibliotekë, që nuk është fare dhe po flasim për Rregullore. Pyetja ime ishte shumë e qartë lidhur me Rregulloren se kur është dalë në dëgjim publik dhe çfarë e drejte është mos me pyet se kur është formuar ky Komision.

Kryesuesi – Pyetja se kur është marrë vendim prej Kuvendit, më duket pak e rëndë. Kjo Rregullore është e sponzorizuar nga DKRS-ja dhe Kuvendi nuk ka marrë vendim për Komision. Unë do ti sugjeroj DKRS-së, që lëndën komplet me ta dhënë.

Rifadije Paloja – Unë do t'iа dërgoj të gjitha në email që anëtar i Kuvendit, të bindet se kjo Rregullore ka shkue në të gjitha fazat e administrimit.

Hysni Mjeku – Draft Rregullorja ka ardhë në Kuvend dhe ne vendosim. Këtu, po kërkohet që anëtarësia e lexuesve të bibliotekës të hiqet krejtë dhe unë me këtë plotësisht pajtoj. Unë jam për me furnizue më tepër bibliotekën, me ble libra sa më shumë dhe me u menaxhue sa më mirë.

Aziz Bici - Çdo respekt për udhëheqësen e sektorit, që edhe pse u mundua ta arsyetoj çmimin që është caktue për lexuesit, unë ua kujtoj një gjë, a e dini ju gjendjen sociale dhe financiare të qytetarëve tonë, a e dini se ka familje që jetojnë vetëm me ndihma sociale dhe a e dini se 20 centë janë shumë për një kategori të qytetarëve. Mendoj se mund të shkon dikush që ka pagesë dhe mund ta joshë edhe dikend tjetër, por sikur të jetë papagesë sigurisht se do të rritet numri i lexuesve. Unë mund të ju them se për 50 centë qytetarët heqin keq, që edhe ju i njihni apo nuk i njihni sepse nuk shkoni fare me atë kategori, prandaj 5 €, janë shumë për një kategori të qytetarëve.

Kryesuesi – Lexon pjesën e dytë për kategoritë e lirimit nga pagesa si anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, personat me nevoja të veçanta etj. Ne mund të shkojmë me një shumë simbolike psh 1, ose 2 euro, sepse e di se pa çmim nuk bën.

Aziz Bici – Ju i përmendët kategoritë e liruara, por prej atyre kategorive ne i njohim disa që i kanë edhe kushtet e mira ekonomike, që edhe me pague nuk bëhet asgjë.

Lulzim Sadiku – Ne thirremi në Ligjin për Obiliqin, prandaj edhe kërkoj që për qytetarët e Obiliqit të hiqet pagesa. Qëllimi ynë është që qytetarët të lexojnë dhe mos t'i kërkojmë pagesë, por qysh ti stimulojmë. Kërkoj që kjo pagesë nëse vetëm duhet të jetë për shkak të Rregullores, atëherë të jetë 0.50 centë për të gjithë qytetarët e Obiliqit, përndryshe nuk pranoj dhe do të jem kundër kësaj Rregulloreje.

Xhezide Dragusha – Pasi që u dhanë shumë vërejtje dhe sugjerime, kërkoj që kjo Draft Rregullore të shtyhet për seancën e ardhshme të Kuvendit, në mënyrë që të rregullohet konform vërejtjeve që u dhanë.

Shaip Paloja – Pajtohem që pagesat mund të jenë më të ulëta, por në asnjë formë të mos jetë pa pagesë. Te shfrytëzimi i Shtëpive të kulturës pajtohem me z.Aziz, që të definohen saktë 3 Shtëpitë e kulturës, e jo vetëm Shtëpia e kulturës në Obiliq. Te përdorimi i Shtëpive të kulturës, duhet saktë të përcaktohet, që besoj se është edhe me Rregullore se kush dhe si mund ta përdorë Shtëpinë e kulturës, bile mund të ndodhë që dikush don ta përdorë Shtëpinë e kulturës, që edhe nëse e paguan shumë nuk bën të lejohet një gjë e tillë, që

e dëmton qytetarin, apo vet Komunën e Obiliqit. Kryesues, kërkoj që Draft Rregullorja të hudhet në votim me propozimin e z.Aziz Bici, 2 apo 3 propozimet të votohen dhe ajo që kalon, kalon.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota “Për” dhe me 6 vota “Kundër” e miratuan Rregulloren për administrimin e Shtëpive të kulturës në Komunën e Obiliqit.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Për një sqarim më të gjerë të raportit finansiar fjalën ia dha drejtoreshës së DEFZH-së.

Zarife Behluli – Ne e kemi bërë raportin 9 mujor për vitin 2019 për 5 kategoritë ekonomike: paga dhe meditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale.

Të hyra vetanake të planifikuara për vitin 2019, kanë qenë 1,035,562 €, të realizuara në periudhën 9 mujore janë 829,630 €, që do të thotë realizimi 80.11 %, ndërsa deri më sot realizimi është vetëm 10 % i painkasuar. Paga dhe meditje për periudhën janar-shtator, buxhet janë 2,956,596.35 dhe shpenzim 2,908,212.21, përqindja e realizimit është 98.03. Mallra dhe shërbime, buxheti është 693,791.09, shpenzimi 402,966.97, realizimi 58 %. Shpenzimet komunale, buxhet janë 330,060.93, ndërsa shpenzim janë 174,916.23, realizimi është 53 %. Subvencione dhe transfere, buxheti është 836,210.69 shpenzimi 338,147 realizimi 40.44 %, investime kapitale, buxheti është 6,571,139.73, shpenzimi 2,427,153.10, që do të thotë realizimi 36.94 %..

Pastaj, drejtoresha dha një sqarim të gjerë për të gjitha Drejtoritë komunale lidhur me kategoritë ekonomike të cekura më lartë.

Kryesuesi – Pyeti nëse, ka dikush nga shefat e grupeve te diskutoj lidhur me raportin finansiar.

Lulzim Sadiku – Kërkoj që në thirrje të shefave të grupeve LDK-në me têrheqë sepse nuk është grup më meqë i ka vetëm 2 anëtarë. Unë e përgëzoj drejtoreshën që ka arritë për herë të parë 2 muaj pa përfundue viti kalendarik 91 % me shfrytëzue buxhetin. Mendoj se është bukur sukses i madh dhe ne do ti japim vërejtjet pasi të përfundojnë projektet, që të jemi më të saktë për gjendjen reale, por mbi të gjitha unë e përgëzoj për punën që është bërë dhe të dhënët që i dha.

Ibush Mjekiqi – Z.Lulzim, tha se është shpenzue 90 % e buxhetit, por mos të keqkuptohemi se nuk është shpenzue, por është mbledhë dhe dikund rrëth 50 % është për investime kapitale.

Aziz Bici – Kjo mënyrë e ndarjes në bazë të prioriteteve, mendoj se nuk është ende duke iu kthyer besimi qytetarëve te pushteti lokal. Në njëren nga seancat e kam pyetur drejtorin se në çfarë mënyre po ndahen subvencionet, sidomos në bujqësi. Këtu, shihet se është një ndarje bukur e madhe e mjeteve, por unë kam informacion se nuk po shkojnë në vendin e duhur. Tani, pyes se a ka Komisione të formuara, apo duhet të formohen për me dalë në terren, me pa se ato mjetet të bujqësisë a i kanë, apo i kanë shitë sepse unë kam informacion edhe me emër. Mirëpo, derisa nuk e kam të konfirmuar duhet të dalë vetë një Komision se vjet i ka marrë mjetet dhe e ka shitë. Sa i përket mbjelljes së drunjëve, në rrugën “Llapi” ju që endeni andej nuk e di a e keni vërejtë se kanë filluar të dëmtohen drunjët e fundit që janë mbjellë. Edhe te rrugët me zhavorr qysh kishim mund me pasë një informacion me ditë se cilat rrugë janë shtrue për këta 9 muaj, e jo vetëm me thënë se kaq kilometra janë shtrue dhe u krye. Te shëndetësia dhe ambienti nuk janë duke u ndarë mjetet e duhura, por vazhdimi shpenzimi i buxhetit shkon në ndërtimin e rrugëve me asfalt dhe jo në ato që janë si uji, kanalizimi të cilat janë të domosdoshme.

Kryesuesi – Vërejtjet që u dhanë besoj se do ti merrni në raportet vjetore kur vijnë të specifikuara. Unë e di nga përvoja se raportet financiare publikohen dhe raportet specifike për çdo rrugë besoj se DSHPE-ja, do ti sjellë. Unë dua të di sa është numri i bizneseve të reja të regjistruara në këtë vit dhe sa janë duke u zhvillue sepse e dijmë me 2 vendimet e fundit të Kuvendit komunal se janë ndihmuar bizneset drejtëpërdrejtë, apo têrthorazi. E di se janë 2 projekte me donatorë gjermanë që duhet ti falenderojmë. Te bujqësia, unë nuk flas me fjalë të rrugëve, por zyrtarisht dhe nëse, janë keqpërdorë mjetet atëherë aty ka vend për Prokurorinë.

Aziz Bici – Pyeti se rapporti i cili do të na dorëzohet në të ardhmen a do të jetë raport i Komisionit që do të delë në terren, të konstaton se a i kanë ato mjetet të punës që janë subvencionu, apo për çfarë raporti është fjala.

Kryesuesi – Përgjegjet se kur vjen raporti finansiar vjetor, ne e shqyrtojmë dhe nëse ke vërejtje mud ta formojmë një Komision nga Kuvendi, ti mund të bëhesh Kryetar Komisioni dhe e verifikojmë gjendjen.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet Draft Strategjinë për zhvillimin e turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore/natyrore 2019-2023 dhe propozon që të formohet një Komision për Draft Strategjinë në fjalë.

Lulzim Sadiku – Propozon që Komisioni ti ketë 5 anëtarë.

Enver Gashi – Propozon z.Muhamed Mustafa, anëtar i Komisionit.

Linda Sadiku – Propozon z.Fatos Kurshumlija, anëtar i Komisionit.

Lulzim Sadiku – Propozon z.Hysni Mjeku, anëtar i Komisionit.

Labinot Mirena – Propozon z.Nazmi Gashin, i cili tërhiqet dhe në vend të tij vjen Rifadije Paloja.

Xhezide Dragusha – Propozon z.Aziz Bicin, për anëtar të Komisionit.

Rifadije Paloja – Komisioni për hartimin e kësaj Strategjie ekziston dhe ne në njëfarë mënyre konsiderojmë se dokumenti është finalizue, por nuk e di se cili është roli i të propozuarve që kishin mund me ndihmues në këtë Draft Strategji sepse kjo veç është hartuar.

Kryesuesi – Përgjegjet se drejtoresha dhe ju e ndihmoni këtë proces duke asistuar me çdo dokument të nevojshëm.

Aziz Bici – E falenderoj udhëheqësen e sektorit e cila na njoftoi se veç qenka një Komision dhe unë tërhiqem sepse vërtetë 2 Komisione nuk kanë kuptim. Ne sa herë që jemi të ftuar do të marrim pjesë në debatet publike, por nuk ka nevojë kurrsesi të mbeten 2 Komisione. Unë nuk jam i interesuar të thirrem vetëm formalisht, por të japë kontribut edhe pse jam shumë skeptik për një Strategji të tillë. Unë jam për një Strategji, por do të ketë punë dhe ka mjaft për të dhënë kontribut rrëth kësaj që na është ofruar prej Drejtorisë, sa që sigurisht se do të na marrë javë e javë të tëra për me dalë një Strategji çfare kishte me qenë në interesin e qytetarëve. Unë sidomos sot ju bëjë thirrje që të respektohen procedurat në debatet publike, duke marrë pjesë sa më shumë qytetarë nëpër të gjitha fshatrat dhe qytetin tonë të Obiliqit.

Kryesuesi – Draft Strategjinë e ka sjellë Drejtoria dhe ne e formojmë Komisionin i cili mund të japë vërejtje, pastaj delë në debat publik dhe këtu nuk ka asnjë të keqe.

Aziz Bici – Unë tërhiqem nga Komisioni sepse nuk është lehtë me zhvillue turizmin dhe do të ketë shumë ndërtime tjera betonjerka, bazë të asfaltit, fabrikë të bllokave, që në të ardhmen do të ndërtohet sigurisht edhe Kosova e re, sipas asaj që jeni deklarue dhe shpresoj se tanë do të ndërron edhe Strategjia. Megjithatë, unë kontributin do ta japë sa herë që kemi informacion dhe jemi të ftuar nga ky Komision.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota “Për” e miratuan Vendimin për themelimin e Komisionit komunal për hartimin e Staregjisë për zhvillimin e turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore/natyrore 2019-2023, me këtë përbërje: Muhamet Mustafa (AAK), Fatos Kurshumlija (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Rifadije Paloja (DKRS), dhe Daut Mjeku (DEFZH).

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet Propozim Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelat Kadastrale në Zonën Kadastrale, në Plemetin.

Fatmir Bërbatovci – Ne jemi duke e realizuar një projekt që është bërë në prill të vitit 2018, në bazë të kordinatave të projektit dhe gjatësia e rrugës është afér 2 km. Ne kur kemi ardhë në fshatin Plemetin 800 metra, nga fundi kemi hasë në një parcelë private, e cila është edhe objekt i shqyrtimit tuaj këtu.

Lulzim Sadiku – Kjo kërkësë ishte edhe në vitin 2018, kur ishte bashkëpunimi me 4 Kryetarët e Komunave, që të lidhet Qyqavica me autostradën e cila e lidhë Prishtinën, Mitrovicën me pjesët kryesore të qytetit. Unë kam qenë pro dhe kam qenë insistues i kësaj kërkëse konkretisht kur kemi biseduar për çështje të buxhetit, që të lidhen fshatrat e Qyqavicës dhe qytetarët e asaj zone. Unë jam pro kësaj kërkëse, por kisha dashur me ditë saktë për pronën që po flasim 300 metra, sa ka hapësirë që duhet të lirohet, do të thotë duhet ti paguhet pronarit, sa është sipërfaqja për të cilën po flasim tash. Drejtori tha se gjatësia prej Plemetinit në Milloshevë është 1,905 metra, ndërsa pak më gjërësisht tha se në 300 metrat e fundit preket

zona për të cilën po flasim. Pjetja është sa ari drejtor janë që duhet të paguhet nga Kuvendi komunal dhe çfarë tarife parashihet ti paguhet toka pronarit.

Fatmir Bërbatovci – Përgjegjet se bëhet fjalë mbi 23 ari m^2 dhe këtu merret një vendim për me shpallë zonë të interesit publik. Procedurat tjera qysh është vlerësimi i pasurisë në këtë rast i bën Ministria e financave sepse këto janë procedura që i parashehë Ligji për shpronësim.

Aziz Bici – Në nenin¹, të Propozim Vendimit thuhet se shpronësimi i kësaj parcele kërkohet me kërkuesën e Drejtorisë së infrastrukturës për të realizuar projektin kapital me shumë rëndësi të një rruge, që do ti lidhë fshatrat e Qyqavicës me Milloshevën. Është dashur me dhënë një përgjegje pse kjo rrugë është me një rëndësi aq të lartë, a është kjo për ti lidhë vetëm fshatrat e Qyqavicës, apo është një projekt i tjetërkujt që ju me dije po e realizoni për të lidhë diçka tjetër dhe çka fitojnë këto fshatra tona Milloshevë, Plemetin. Mua, më kujtohet se në vitin e kaluar e kemi votuar një memorandum bashkëpunimi në mes të Kryetarit tonë dhe të Drenasit, Skënderajit, Mitrovicës dhe Vushtrrisë. Pastaj, jo që ka pasë diçka ndërtimi i një projekti përvëç se ndoshta në të ardhmen atje do të ndërtohet ndonjë pushimore, restorant, e jo më tepër. Unë nuk e besoj pas 20 vitesh tashmë kur më fshatrat e Qyqavicës, e sidomos fshatrat tona veç kanë filluar të shpërngulen, që ndoshta me minjerën e re do të vazhdon shpërngulja, unë nuk e konsideroj si projekt tejet të rëndësishëm. Përkundrazi konsideroj se kjo rrugë mos të ndërtohet me ato standarde çfare po kërkohet. Ne kemi edhe rrugë tjera, që janë zënë nga qytetarët e pandërgjegjshëm dhe nuk ka asnë iniciativë që të zgjerohen këto rrugë, që lëvizja e qytetarëve të jetë më e lirë. Ne do të jemi kundër asaj që të bëhet shpronësimi i kësaj sipërfaqeje, jo pse jemi kundër dhe nuk e njohë këtë qytetar, por sepse kjo rrugë nuk ka nevojë të jetë me ato standarde përderisa ju veç e keni nisë ndërtimin e saj. Përndryshe, kjo nuk është dashur të ndërtohet me këtë prioritet në këto rrrethana dhe ne do të votojmë “Kundër”.

Nazmi Gashi – Unë e mora këtë hartë 62 m, diferençë që drejtori i infrastrukturës na e shpjegon, është hapë traseja e re që i ka ikë rrugës ekzistuese dhe të njejtat pika të territorit po i lidhë. Nëse, mundet drejtori na e shpjegon se nga erdhi kjo ide, kush e ka kërkuar.

Muhamed Mustafa – Në gjeoportal e kam pa se rruga që i lidhë fshatrat e Qyqavicës përmes Plemetinit me Milloshevën, ekziston me gjerësi të mjaftueshme, me hapësirë edhe më të madhe se kjo që është propozue mbi 23 ari. Pra, rruga ekziston, por është duke u shfrytëzuar nga qytetarët dhe vetëm 61 metër është një rrugë tjetër, 70 metra është rruga tjetër, ndërsa pika më e lartë prej parcelës ku është propozue për shpronësim është 107 metra. Qytetarëve ju bjen me shkue 107 metra më largë dhe me u kthye në rrugën ekzistuese, që është me kadastër. Mendoj se duhet të jemi pak më sy çelë kur është në pyetje buxheti dhe paraja publike, mos të shkojmë me shpronësimë të panevojshme sepse këto rrugë janë të Komunës, janë tonat. Më mirë është të punohet në atë drejtim ku askush nuk mund ti ndalë punimet se sa me bë shpronësimë tjetra. Këtu, është propozue me u bë vetëm një shpronësim i kësaj parcele, por afér saj edhe 9 metra duhet të shpronësohet edhe një parcelë tjetër për me dalë në rrugën këtu ku është. Nëse, ka mundësi drejtori të na japë shpjegim më të qartë pse kërkohet ky shpronësim këtu.

Kryesuesi – Shpronësimet bëhen në interesin e përgjithshëm publik dhe projektit që e përmendi drejtori është i vitit 2018, kur e ka gjetë të hartuar nga kompania e menaxhuar nga ish drejtori i kaluar.

Muhamed Mustafa – Në asnë mënyrë të mos kuptohet se jam kundër lidhjes së fshatrave me rrugë me standarde të larta, por kur ekziston rruga pse bëhet shpronësim dhe duhet të llogaritet nëse, shtrohet kjo rrugë nga është propozue këtu, pjesa tjetër po ju lejohet qytetarëve. Kjo do të thotë edhe 30 ari me u uzurpue, me u shfrytëzue qysh është duke u shfrytëzue tash. Mendoj se edhe kjo është e kundërligjshme në njëfarë aspekti dhe jam për atë që të analizohet mirë kjo çështje dhe të mos kërkohet prej neve me votue.

Fatmir Bërbatovci – Unë fillimisht e thashë se ne jemi duke punuar me një projekt i cili është hartuar në prill të vitit 2018 dhe janë caktuar kordinatat. Parcelsa që po e përmendë z.Muhamed, që e ka nxjerrë prej gjeoportalist edhe unë e kam vërejtë, por kur është dhënë detyra projektuese kjo parcelë që është objekt i shpronësimit e ka formën tipike të rrugës dhe në atë parcelë që ne dojmë me shpronësue është bërë projekt. Ndërsa, frigën e z.Muhamed se ajo rrugë e rendit të 4, e cila i ka dikund rrëth 5 metra, që nuk i përmblushë kërkuesat e projektit që jemi duke e realizue, ajo nuk u jepet uzurpatorëve. Ajo është rrugë e arave dheasnë

rrugë ne nuk ia japid askujt sepse kryesues e ke edhe një interpretim të MAPL-së, se gjithçka mund të jepet në shfrytëzim, por rruga nuk mund të jepet në shfrytëzim, as nuk tjetërsohet.

Hysni Mjeku – Mendoj se ndërtimi i rrugëve dhe urave është interes i komuniteteve dhe jam pro kësaj pavarësisht kudo që të jetë. Ne tash mund të merremi me shumë analiza, shumë propozime, shumë diskutime, por mbi të gjitha unë jam pro këtij projekti me vetë faktin se organet profesionale si qëndrore ashtu edhe lokale e kanë konstatuar se një rrugë e tillë është e nevojshme për komunitete. Prandaj, jam pro kësaj dhe nuk jam kundër ndërtimit të urave dhe të rrugëve.

Labinot Mirena – Pyeti se a ka fillue kjo rrugë të ndërtohet.

Fatmir Bërbatovci – Përgjegjet po.

Labinot Mirena – Si mund të filloj rruga me u ndërtue kur nuk ka dalje sepse ai që e ka bërë projektin është dashur me pa se a ka dalje rruga, apo nuk ka, e jo me ia nisë projektit me thënë se dalë dikund. Kjo është para publike dhe për mendimin tim është gabim sepse kur është bërë projekti pajtohem plotësisht se drejtori e ka gjetë ashtu, por ata që e kanë bërë projektin ashtu pa e ditur se ku po dalin në çfarë parcele, ata kanë gabue. Tash, në këtë rast ne jemi viktima të tyre.

Kryesuesi – Në parim është ashtu, por gjithsesi drejtori le ta merrë si rekomandim, që ata të cilët e kanë pranuar këtë projekt ti kryejnë procedurat dhe nëse, nuk i kryejnë vendosni ju. Poashtu, pasi të kryhen procedurat drejtori duhet të merret me përgjegjësi me atë projekt ashtu qysh e ka gjetë, qysh e ka pranue me shkue deri në fund. Drejtoria duhet ti specifikoj problemet që në të ardhmen mos të na përsëriten.

Labinot Mirena – Mund të jetë ai që e ka dërgue projektin andej e ka mik këtë të tokës dhe i ka thënë e sjellë nga ju dhe ta bëjë një shpronësim. Për Komunën 10,000 €, nuk janë asgjë, por për atë që e merrë atë tokë ndoshta, ai nuk mundet me shitë kurrë 10,000 €. Këtu, mund të ketë konflikt interes, për atë edhe unë e shpreha si shqetësim.

Kryesuesi – Nëse, ka konflikt interes është Prokuroria, por s'besoj se ajo mundë të ndodhë.

Shaip Paloja – Z.Muhamed, e sqaroi shumë mirë, është duke më habit qysh thanë edhe parafolësit një rrugë që ekziston dhe ka ekzistue edhe më heret nuk përdoret e njejtë rrugë, por kërkohet edhe një shpronësim. Tash ne të shpallim zonë me interes një pronë private kur ekziston rruga përnjëmendë është për me u habitë, pse. Mendoj se duhet të shqyrtohet mirë e mirë sepse këtu në një formë mund të jetë edhe konflikt interes, ndoshta do të jetë edhe interes personal i dikujt. Unë jam për atë që të mos votojmë sot.

Fatmir Bërbatovci – Unë nuk kam arsyetim jetër përveç se me i përsëritë edhe njëherë fjalët sepse atë që e pata e thashë. Ne mundemi me ndalë punën dhe me na humbë mjetet, ndërsa ajo që po ia japid rrugën uzurpatorëve s'po i kuptoj këto gjëra.

Nazmi Gashi – Tash, drejtorin po e sjellim në atë situatë sepse është shpjegimi ajo që e tha vetëm me përsëritë deri nesër. Projekti ka qenë i përgatitur më heret dhe tash është me rëndësi participimi. Dosido nuk ka rrugë që nuk i vyen dikujt dhe nuk ka rrugë që është e keqe.

Aziz Bici – Unë për vete personalisht dhe ne si LVV, bashkë me një numër të banorëve të fshatit Plemetin kemi një shqetësim sepse atje po vazhdojnë të ndërtohen shtëpi. Pajtohem me atë që e diskutuam pak a shumë që the mos e ke atë brengë sepse nuk është ai qëllim.

Kryesuesi – Këtë do ta diskutojmë në pikën “Të ndryshme”.

Aziz Bici – Në rast se shtyhet ky projekt për herën tjetër është në rregullë sepse për mua nuk shkon në interes që kjo të votohet. Këta anëtarë të Kuvendit duhet të më bindin mua, kur jam në gabim dhe unë duhet me i bindë këta kur e kanë gabim sepse shqetësimet tonë të njëri tjetrit ne duhet ti diskutojmë. Në fund të fundit ne pse vijmë dhe i takojmë një subjekti politik, ne duhet ti mbrojmë interesat e qytetarëve.

Muhamed Mustafa – Tash më intereson pse nuk është kërkue të shpronësohet edhe parcela nr.007815, e cila nëse punohet deri këtu, bëjmë asi gabimi dhe po na shtrohet rruga deri këtu, pronari i kësaj parcele do të kërkon mjete sa të don nëse, nuk e shpronësojmë edhe atë pjesë të asaj rruge. Tash, ku guxon me u bë ky propozim me mbetë një pjesë 9 metra, gjatë si dhe 6 metra gjerësi, parcelë e plotë që s'ka dalje prapë. Këtu, po shihet se diçka nuk është në rregullë dhe pse nuk vazhdohet në rrugën ekzistuese, që i potëson të gjitha standarde dhe ka gjerësi të mjaftueshme.

Armend Rushiti – Edhe unë jam kundër këtij propozimi që me vazhdue më tutje me arsyetimet që këtu, u dhanë.

Fatmir Bërbatovci– Duhet të aprovohet kërkesa për shpronësim, është një kontratë e lidhur në vlerën prej 180,000 €, 100,000 €, janë nga Ministria dhe 80,000 €, janë tonat. Tash është një shpronësim që do të bëhet që dikush e dha vlerën 300-400 €, dhe për 10,000 €, ne rrezikojmë me i humbë mbi 100,000 euro dhe ky është aspekti praktik. Z.Muhamet që tha 9 ari, ato janë pronë shoqërore të KBI-së, juridikisht dhe tash është rrugë faktike dhe ne në këtë fazë aty nuk kemi problem. Në fazën e mëvonshme mundemi me i përfshi se ato punë që i bënë, që po i vëren z.Muhamet i kemi vërejtë edhe ne pasi kemi fillue me realizue projektin. Eshtë dashur në fillim kur është dhënë detyra projektuese të parashihen këto, nuk janë paraparë dhe tash jemi këtu, ku jemi.

Hysni Mjeku – Mendoj se këtu, është interes i madh i qytetarëve se sa disa individë psh që diskutojnë në mënyrë paushalle. Do të thotë 180,000 €, janë paraparë me u ndërtue kjo rrugë dhe nëse, ne jemi pro largimit të këtij projekti, konsideroj se nuk përkon me interesin e qytetarëve. Unë nuk dua të hy në ato gjëra se a ka interes sepse çdo rrugë ka interes, por mbi të gjitha është interes i shoqërisë dhe komuniteteve, që gravitojnë atje. Këto, janë spekulime dhe kush din diçka janë organet ku mund të jepen ankesat. Këtij projekti duhet ti themi po sepse është një shumë bukur e madhe e mjeteve, ndërsa me pengesat teknike besoj se Ekzekutivi duhet të merret dhe me vazhdue me projekte tjera.

Labinot Mirena– Z.Hysni, ne nuk jemi kundër investimit prej 180,000 €, por jemi kundër atyre që e kanë bërë projektin e keq. Unë këtë e kisha votue kur drejtori kishte me na sjellë kur ndaj atyre që e kanë bërë këtë projekt të keq, që na kanë futë neve në një rrugë pa dalje, që ju ka dhënë vërejtje, i ka dërgue në shtëpi, i ka suspendue. Pra, pse me votue unë këtë kur ai e bën projektin e keq dhe ky është mendimi im personal me të vërmën arsy se ata që e kanë bërë projektin e keq, duhet me marrë denimin e merituar pa marrë parasysh kushdo qoftë. Unë e votoj projektin e mirë.

Muhamet Mustafa – Më vjen keq prej z.Hysni, që po thotë mendime paushalle dhe ne paushall nuk folëm, por folëm me argumente, paushall foli dikush tjetër. Ne nuk jemi kundër projektit, as asaj vlere, por jemi që 61 metër e mëtutje ku është prona ekzistuese e Komunës, të vazhdon projekti dhe të kryhet rruga, ndërsa jam kundër atij shpronësimi.

Nazmi Gashi – Është shpjegim profesional se ne nuk guxojmë të thirremi në projekt sepse ai që e ka fitue të drejtën sigurisht se është më i mirë dhe ka njohuri më të mëdha se ne. Sa i përket parcelës drejtori e dha shpjegimin dhe ne nuk kemi mbetë për 10,000 €, me humë projektin prej 200,000 €. Mendoj se sa rrugë të ndërtohen është në interes të qytetarëve dhe ne nuk duhet të merremi me gjëra banale.

Lulzim Sadiku – I falenderoj shumë kolegët, që më kanë bindë se kanë të drejtë pozita në këtë aspekt dhe unë do të jem pro kërkësës, që kanë ofruë këta sepse po flasin me fakte. Nëse, ka rrugë edhe unë kërkoj të mos shpenzohet edhe pse pyeta për shumë, për largësi, pyeta sa ari janë dhe sa mund të jetë pagesa. Unë e mbështesë projektin që e thojnë kolegët nga pozita dhe i falenderoj se vërtetë janë brilantë.

Kryesuesi – Të nderuar kolegë, i kemi 2 propozime, 1. Propozim Vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në Plementin dhe propozimi 2, të shtyhet kjo çështje për mbledhjen e radhës.Tani, e hudhi në votim propozimin e parë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 7 vota “Për” dhe 7 vota “Kundër” nuk e miratuan Propozim Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelat Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plementin.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet shkresën nga MAPL-ja, për shfuqizimin e vendimit nr.I-150, të dt.30.08.2019.

Lulzim Sadiku – Kërkoj që drejtori të dalë në foltore dhe të na bindë neve, pse duhet ta shfuqizojmë vendimin.

Kryesuesi – Drejtori mundet vetëm me sqarue, jo me të bindë, dhe z.Lulzim, mos bëjë politikë.

Lulzim Sadiku – Interesantë po bëjë politikë pse pyeti për diçka që është e qartë. Nëse, bëhen gabime të tilla, kërkoj me marrë një mocion me të largue ty sepse po na vijnë shumë vendime të cilat duhet ti shfuqizojmë. Atëherë, kërkoj drejtori të na sqaroj çështjen përndryshe jam “Kundër”.

Hysni Mjeku – Në KPF, kemi diskutue dhe kemi dhënë vërejtje të fundit se vërtetë organet profesionale të Komunës, po na vënë në lajthitje dhe nuk ka më logjikë që vendimet e Kuvendit të kthehen. Në fund të fundit përgjegjësia duhet të kërkohet te ata njerëz që kanë ardhë para Kuvendit dhe na kanë arsyetue me marrë një vendim të tillë. Vendimet kur kthehen është puna e mossuksesit dhe unë nuk dua para elektoratit tim me dalë i pasuksesshëm, por dua të dalë i suksesshëm me objektivat që i kam marrë nga elektorati që vijë. Prandaj, është vërejtja e fundit që neve, na kthehen këto vendime.

Aziz Bici – Shpesh janë duke na u përsërëtë se ne duhet ti shfuqizojmë vendimet që po i marrim. Është mirë të fillojmë nga sot se çdo Drejtori që na i sjellë vendimet duhet me dalë para neve me na dhënë një arsy, që është në interes të tyre. Në rast se ne vazhdojmë dhe nuk kërkojmë llogari prej tyre, këta sigurisht se më vjen keq që po e them se kanë me vazhdue dhe me i neglizhue punët dhe ne do të vazhdojmë prapë si në të kaluarën, me i shfuqizue vendimet. Kërkesë e imja është ti dijmë arsyet sepse këtë vendim ne nuk e kemi kerkuar si Kuvend komunal, por e kanë sjellë vetë, e kanë pasë kohën e mjaftueshme dhe i dijnë arsyet.

Armend Rushiti – Ministria e shëndetësisë arsyetimin e ka dhënë shumë qartë se kjo Strategji nuk është bërë në kordinim me Ministrinë e shëndetësisë, që do të thotë se ai është organi më i lartë që bën politikat shëndetësore në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor. Problemi është këtu, se është dashur me qenë në kordinim me ata, në mënyrë që mos me humbë ky dokument ligjshmërinë.

Haki Jashari – Sqaron se çështja thelbësore është se ne nuk jemi në kundërshtim me ligjin, por Ministria e shëndetësisë është përgjegjëse për të bërë strategji, ashtu si jemi përgjegjës edhe ne dhe problemi është se ne i kemi parapri kësaj strategjie. Problemi është te emërtimi i dokumentit dhe Komunat tjera që nuk e kanë quajtë strategji, por plan zhvillimor nuk ju ka ardhë me shfuqizue. Tash, pse e kemi quajtë strategji, ne jemi nisë nga Statuti i Komunës, neni 88, te kompetencat e Drejtorisë së shëndetësisë, në të cilin thuhet se ka të bëjë me hartimin dhe zbatimin e Strategjisë për kujdesin parësor shëndetësor. Mendoj se është një dokument shumë i rëndësishëm dhe ashtu siç tha kryesuesi duhet ta shfuqizojmë.

Pas diskutimeve anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota “Për” e miratuan Shfuqiozimin e vendimit nr.I-150, të dt.30.08.2019, për aprovin e Planit Parësor Shëndetësor për Komunën e Obiliqit 2020-2024.

Kryesuesi – Paraqet shkresën nga MAPL-ja, për shfuqizimin e vendimit nr.I-172, të dt.24.09.2019.

Nazmi Gashi – Qasja qysh po e kërkojnë pronën është e gabuar.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota “Për” e miratuan Shfuqizimin e vendimit nr.I-172, të dt.24.09.2019, për aprovin e kërkesës nga banorët e fshatit Llazarevë dhe rekomandimeve të DPUKP-së, për ndarjen e 50 m^2 pronë shoqërore komunale me nr.të parcels P-726014041000-54-0, ZK Llazarevë.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet reportin periodik për zbatimin e rekomandimeve, nga raporti i auditimit për Komunën e Obiliqit, viti financiar 2018.

Pastaj, kryesuesi i njoftoi të pranishmit me kërkesat që iu drejtuan Drejtorive përkatëse për shqyrtim.

Tash, e kemi kërkesën nga DSHPE-ja, për formimin e Komisionit për hartimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës, KEDS-it dhe KESCO-s, për subvencionimin e energjisë elektrike.

Naim Miftari – Sqaron formimin e Komisionit për hartimin e marrëveshjes në mes të Komunës, KEDS-it dhe KESKO-s, për subvencionimin e energjisë elektrike. Pas hartimit të kësaj marrëveshjeje juve, do të ju vjen në Kuvend për aprovim.

Labinot Mirena – Propozon z. Enver Gashi, anëtar të Komisionit.

Labinot Mirena - Propozon z. Shaip Paloja

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota “Për” dhe 3 vota “Kundër” e miratuan Vendimin për formimin e Komisionit për hartimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të

Komunës së Obiliqit me KEDS dhe KESCO, për subvencionim të energjisë elektrike me këtë përbërje: Naim Miftari, Fitore Hashani, Zarife Behluli, Enver Gashi dhe Shaip Paloja.

Kryesuesi – Paraqet kërkësën nga banorët e fshatit Grabofc, për kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit të nxënësve, të cilët udhëtojnë në Fushë Kosovë.

Agim Spahiu – Në Rregulloren e aprovuar nuk parashihen kategoritë që janë banorë të Komunës së Obiliqit, nxënës dhe vijojnë mësimin në një Komunë tjetër. Ato kategori përjashtohen me përjashtim të rasteve kur nuk ka profile të tillë, në Komunën tonë. Sigurisht këta e kanë pasë parasysh këtë fakt, e kanë analizue Rregulloren dhe e kanë bërë kërkësën, ndërsa Kuvendi është për me aprovue, apo mos aprovue.

Lulzim Sadiku – Sipas Rregullores, ata nuk mund të paguhen, por unë kërkoj që ata të paguhen sepse ata mund të janë edhe nxënës të profileve që nuk ka Komuna e Obiliqit. Ne po ju japim përparësi fshatrave që mos të largohen njerëzit nga fshatrat dhe unë kërkoj që atyre nxënësve t'iu bëhet një zgjidhje nga Kuvendi komunal. Ata janë banorë të Komunës së Obiliqit, i paguajnë taksa Komunës dhe atyre duhet të ju bëhet zgjidhje me transport njëherë në mëngjez dhe njëherë në drekë kur ata kthehen.

Hysni Mjeku – Vërtetë, kemi të bëjmë me një problem jashtëzakonisht jetik sepse ne jemi kundër migrimeve të popullatës. Ne e dijmë se ajo zonë faktikisht po e përjeton një fat shumë të keq, mbi 60 % e popullatës janë të shpërngulur dhe ka mbetë një pjesë e një substance që duhet të ruhet. Unë e kuptoj drejtorin se çdo gjë nuk mund të precizohet në Rregullore, por me një vendim të veçantë të këtij Kuvendi, duhet me i dalë në ndihmë këtyre nxënësve. Ne nuk guxojmë një problem të tillë ta lejmë në heshtje sikur asgjë nuk po ndodhë sepse vërtetë ajo zonë don një trajtim të veçantë nëse, dojmë me shpëtue këtë popullatë. Unë jam pro pagesës së shpenzimeve të udhëtimit të këtyre nxënësve sepse Komuna ka mjete.

Nazmi Gashi – Kërkoj të mos thirremi në Rregulloren e Arsimit, por në specifikat e Kuvendit komunal dhe atyre nxënësve t'iu ndihmojmë.

Aziz Bici – Kërkoj që të konsultohet zyra për çështje ligjore që të gjendet mundësia e pagesës të këtyre nxënësve. Propozimi im në vitin e kaluar ka qenë ndërtimi i rrugës që gjendet brenda minjerës së thëngjillit, që mendoj se është shumë më i rëndësishëm se sa projekt i rrugës, që është duke u ndërtuar për të cilin folëm më heret. Unë edhe në vitin e kaluar e kam arsyetue se ajo rrugë është aq e rëndësishme sa që jo vetëm që i lehtëson banorët e Grabofcit dhe Shipitullës, por e rritë edhe frekventimin e banorëve të Drenasit dhe Skënderajit, që Komuna jonë ka interes. Prandaj, ju duhet me pasë parasysh ndërtimin e kësaj rruge.

Bejtullah Mjekiqi – Mendoj se ka mundësi me një vendim të veçantë duke preferuar që në të ardhmen edhe në Rregullore të bëhet një plotësim për shkak se është një zonë e veçantë, ku nuk ka kurrfarë transporti për Grabofc dhe Shipitullë. Ju lutem të keni parasysh për ata nxënësa sepse 80-90 %, janë raste sociale.

Shaip Paloja – Gjithnjë kemi mirëkuptim për ata nxënës, por ne jemi të obliguar dhe Ekzekutivi është i obliguar me zbatue Rregulloren, që është votue në këtë Kuvend. Nëse, nxjerrim një vendim të veçantë për këta nxënësa, duhet ta dini se duhet me nxjerrë edhe në pjesët tjera të Komunës tonë, vendime të njejta. Pra, nëse i shmangemi Rregullores, ta dini se duhet ti shmangemi edhe për shumë raste tjera.

Agim Spahiu – Unë jam pro për këto kërkesa për kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit. Ju njoftoj se janë 444 aplikacione për shpenzime të udhëtimit, janë 166 aplikacione për bursa për studentë dhe 59 aplikacione për bursa për nxënësa dhe janë 2 Komisione që po punojnë.

Hysni Mjeku – Mendoj se nuk duhet të bëhet një simetri e tillë në mes të Grabofcit dhe rajoneve tjera, qysh u tha para këtij diskutimi sepse unë çdoherë nuk kam qenë lokalist pavarësisht interesit duhet të jetë i përgjithshëm. Mirëpo, të bëhet një krasim i tillë në mes të Grabofcit, Palaj dhe Sibofcit vërtetë është shumë e dëmshme për shoqërinë tonë dhe neve, si individë. Ne duhet të jemi pak parimor në këtë drejtim sepse situatën që gati çdonjëri e din, andaj këtyre nxënësve siç u potencua se shumica janë me asistencë sociale, duhet t'iu ndihmohet. Nëse, ne nuk ndërmarrim masa tash, atëherë në vitin e ardhshëm ne ose duhet të bëjmë shpërngulje kolektive, ose diçka duhet të bëjmë. Mbi të gjitha ne si Kuvend duhet të reflektojmë pozitivisht ndaj këtyre banorëve, derisa duhet të ndjehemi krenar me kontributin e dhënë të këtyre fshatarëve si Shipitull si Grabofc. Unë jam pro zgjidhje të problemit të këtyre nxënësve sepse Komuna ka mundësi buxhetore.

Shaip Paloja – Unë nuk e potencova as Palaj, as Lajthishtë dhe unë thashë nëse i shmangemi Rregullores, do të kemi problem edhe me të gjitha pjesët e Komunës, rasti konkret familja te Shkabaj, që është që edhe atyre me ua mundësue duhet me shkelë Rregulloren. Unë tjetër gjë nuk kërkova përvëç nëse, bëjmë shmangje nga Rregullorja, atëherë duhet të jemi të barabartë për të gjithë.

Nora Preniqi – Besoj se edhe banorët e fshatrave tjerë, duhet të janë dakord me këtë vendim për shkak se ndoshta nuk krahasohen sepse banorët e fshatrave tjera, ndoshta kanë mundësi me i dërgue fëmijët e tyre në shkolla që janë në territorin e Komunës së Obiliqit. Mirëpo, këta as në territorin e Komunës së Obiliqit nuk paskan mundësi, prandaj duhet t'i u dalim në ndihmë. Mendoj se edhe fshati Mazgit, konkretisht ndoshta nuk ka mundësi me ardhë në Obiliq, por nuk krahasohet me këtë region.

Lulzim Sadiku – Të jemi të qartë për një numër të anëtarëve të Kuvendit, që janë pak më të vjetër si z.Hysni, Enveri dhe unë se vërtetë, Grabofcit ne asnjëherë nuk kemi mund me i dërgue autotransport prej Komunës tonë. Është i vetmi vend Grabofci dhe Shipitulla, që nuk kanë transport të Komunës dhe kërkoi që t'i u paguhet fëmijëve të zonës Shipitullë dhe Grabofc, një autotransport për bartje. Unë e dëgjova nga LVV, që në fakt e tha shumë mirë çështjen e KEK-ut. Ju njoftoj se aty është shtruar rruga në asfalt dhe kërkoi nga Kryetari dhe Kuvendi me formue një Komision, me gjetë një konsensus që me i lejue fshatrat që të hyjnë në mes të KEK-ut dhe të vijnë në zonën për të cilën po flasim. Nga LVV, ishte pyetja shumë konkrete se është mirë me bisedue me KEK-un dhe me i lejue punëtorët dhe anën Shipitullë dhe Grabofc, që të udhëtojnë për Obiliq, nëpër korporatë ku është shtrue ajo rrugë.

Kryesuesi – Sqaron se Kryetari i Komunës ka 5 vite, që është marrë me atë çështje, me kërkeshën për rrugën e miqes dhe dihet sabotimi që është bërë nga ana e tyre, për fat të keq ata nuk janë duke e respektue dhe Ligjin për Obiliqin dhe vendimet e këtij Kuvendi komunal. Ata janë duke u ballafaquar në Gjykatë me argumentet e Kuvendit komunal të Obiliqit dhe të Ekzekutivit.

Enver Gashi – Unë nuk e di pse aq shumë diskutohet për 9 nxënësa të Komunës tonë dhe ia vlen me i ndihmues pasi që ne nuk kemi transport andej. Ne e humbim një orë këtu për një pagesë simbolike 1 euro, në ditë që nuk kushton më shumë se 9 euro. Aq shumë bëhet polimikë për këta nxënësa që ia vlen me i ndihmues edhe nëse janë të Komunës tjetër, e jo që janë të Komunës tonë. Kuvendi komunal ka të drejtë të marrë vendim të veçantë për këta nxënësa, por nëse hasim edhe në pjesët tjera, e vlerëson Kuvendi.

Aziz Bici – Nëse, flitet për Rregullore duhet të votojmë, por pasi që flitet për vendim, mendoj se këtu nuk kërkohet votim, sepse ne u deklaruam të gjithë dhe jemi të regjistruar se askush nuk e kundërshton kompenzimin e këtyre nxënësve. Prandaj, të mos votojmë nëse nuk është për neve me votue sepse këtu, fjala është përmarrjen e një vendimi në rast se lejon ligji.

Shaip Paloja – Vetëm mos të delë se unë dhe dikush tjetër jemi kundër me iu ndihmues atyre nxënësve, në asnjë mënyrë hiç. Kërkoi që mos të shkelet Rregullorja sepse refuzohet vendimi dhe të gjendet forma që t'i u ndihmohet të gjithëve, gjithsesi edhe këtyre të Grabofcit.

Aziz Bici – Ne thamë më heret se do të kërkojmë përgjegjësi prej të gjithë atyre pa u konsultue me zyren ligjore, në rast se kërkohet nga MAPL-ja për me i shfuqizue vendimet. Atëherë, qysh ka mundësi më heret marrim kësos qëndrime dhe pastaj, menjëheherë e shohim se po shkelen. Prandaj kërkoi të konsultohen me zyren për çështje ligjore.

Kryesuesi – Drejtore a kemi të drejtë të marrim një vendim të tillë apo jo.

Agim Spahiu – Kryesues, unë nuk jam jurist, as nuk jam zyrë ligjore, jam drejtor i Arsimit dhe a keni të drejtë apo nuk keni, ju konsultone zyren ligjore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht miratuan Vendimin që t'i u ndihmohet nxënësve të fshatit Grabofc i Epërm për kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit, numri i nxënësve sipas kërkeshës është nëntë gjithsejt.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkeshën nga z.Armend Rushiti dhe ia dha fjalën për një sqarim detali.

Armend Rushiti – Sqaron se kërkesa është nga banorët e fshatit Mazgit dhe Llazarevë, drejtuar Kryetarit të Komunës, Kuvendit komunal, DI-së dhe DMM-së. Kërkesa ka të bëjë me inspektimin e pronës komunale në

fshatin Mazgit dhe Llazarevë, që në mënyrë të kundërligjshme është e uzurpuar, degraduar dhe ndotur nga Drejtoria e fabrikës “Apollonia”. Kërkesës i janë bashkangjitur 5 shtojca dhe një CD me video. Kërkoj që CD-ja si dëshmi të shikohet nga anëtarët live këtu, në Kuvendin komunal. Këtu, i kemi 2 përgjegje nga MAPL-ja, që kanë marrë banorët e këtyre fshatrave dhe këto vendime iu kanë dorëzue Kryetarit të Komunës dhe kryesuesit. Unë po e ceku vetëm vendimin e fundit të dt.17.10.2019, që ka marrë MAPL-ja, se vendimi i Kuvendit komunal nr.153, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në ZK, në Llazarevë përfitues “Apollonia” është në kundërshtim me ligjin dhe Kuvendi komunal është i obliguar ti shqyrtoj ankesat e dhe peticionet banorëve të fshatit Llazarevë dhe Mazgit. Ju prapë vazhduat me votue të njejtin vendim pa e shqyrtue peticionin e këtyre fshatrave dhe kjo është shumë e pakuptimtë.

Aziz Bici – Anëtarët e Kuvendit i kanë llap topët dhe atë CD mund ta shikojnë.

Armend Rushiti – Kërkoj CD-ja, të shikohet këtu, në mbledhje nga të gjithë. Është për keqardhje mosreagimi juaj dhe peticioni i nënshkruar prej 50 banorëve, e ju me i myllë sytë dhe me votue diçka të kundërligjshme, për këtë ka me pasë padi dhe dikush ka me pasë edhe pasoja.

Kryesuesi – Ju sqaroj se MAPL-ja, i ka kthye 2 përgjegje dhe unë e kam njoftuar Ministrinë dhe Kryetarin e Komunës, lidhur me ankesën e banorëve të Mazgitit dhe Llazarevës. Ju informoj se për lëndën që e kanë ofruë banorët me peticion kanë marrë përgjegje nga DI-ja, dhe DMM-ja. Lënda e tyre nuk ka ardhë në adresë të Kuvendit komunal, por ka shkue në Ekzekutiv dhe ata i kanë dhënë përgjegje.

Aziz Bici – Unë kam votue kundër dhënies në shfrytëzim të pronës komunale për “Apolloninë” sepse nuk ma ka mbushë mendjen se vërtetë i plotëson kushtet me ia dhënë pronën në shfrytëzim për 99 vite. Ankesa e 2 fshatrave më ka ardhë sot dhe e shohë këtu se kërkesa është e dt.28.10.2019 dhe jeni edhe ju kryesues me këtë datë. Në rast se DI-ja, ose DMM-ja, nuk i merrë masat e nevojshme, atëherë ne sigurisht bashkë me komunitetin do ta dërgojmë mëtutje lëndën, por shpresoj se ju do ta merrni seriozisht këtë punë dhe të merren masat e duhura sipas ligjit.

Armend Rushiti – Kërkesa është dorëzue në Komunë me dt.28.08.2019, dhe pse nuk është dorëzue në Kuvend, atë ditë kur të kam pyet kryesues në mbledhjen e kaluar, ke thënë nuk e di. Poashtu, nuk të është dukë e arsyeshme me paraqitë në Kuvend, peticionin e nënshkruar prej më shumë se 50 banorëve, që unë nuk e di se ku është problemi. Dëshmitë, vendimet dhe videot janë prandaj, dikush ka me dhënë përgjegjësi.

Kryesuesi – Sqaron se kërkesa në fjalë në Kuvend nuk ka ardhë sepse unë jam i obliguar kërkuesat ti paraqesë në KPF, pastaj në mbledhjen e Kuvendit, por kjo kërkuesë te unë nuk ka ardhë.

Aziz Bici – Unë prapë e mora fjalën me dëshmue këtu, se nuk është fjala se këta janë kundër pronës edhe pse unë kam qenë kundër dhënies së pronës. Këtu, thotë humnera e hapur në pronën shtetërore, që të gjithë e dijmë se humnera është një gropë e madhe, që rrrezikon jetën e njerëzve dhe të tjerëve. Pastaj, prona shtetërore e uzurpuar dhe rrëthuar me tel, kjo nuk lejohet sepse qysh mundesh me rrëthue një pronë që nuk është e jotja dhe këtë duhet me konstatue inspektorati. Tjetra, mbeturina në pronën shtetërore, a ka logjikë me përdorë pronën pa një leje nga organi përkatës i Komunës. Këto, janë dëshmi të mjaftueshme dhe tymi nga tymtari për shkak se është fotoja këtu dhe shihet tymi, që dëshmon se këta banorë janë kundër asaj që ai është duke bërë në mënyrë të kundërligjshme. Unë kërkoj nëse neve, na lejohet që raportet e inspektoriatit dhe DMM-së, të na i dërgoni përmes adresës elektronike.

Lulzim Sadiku – Sa i përket kësaj parcele, unë kam votuar kundër dhe qëndroj prapa asaj që kam votuar. Kjo është shqetësuese ndaj atyre banorëve, që ata e kanë bërë këtë kërkuesë dhe me siguri pronari për të cilin po flasim e ka marrë pronën, është duke i shkelë Rregulloret për të cilat është folë. Edhe kur është dhënë kjo pronë ne kemi kërkuar të dijmë për ata punëtorë për të cilët është premtuar se do të hyjnë në punë, apo ata që i ka aty të dijmë se kush janë dhe kjo nuk ka ndodhë. Unë jam për atë që banorët të cilët kanë bërë kërkuesë për ambientin, kjo kërkuesë të përfillet. Kryesues, nëse një anëtar i Kuvendit ka ardhë në Kuvend me votën e qytetarit dhe kërkon ta shikojmë këtë CD, unë kërkoj ta shikojmë këtë CD. Kërkoj të krijohen kushtet dhe ta shikojmë të gjithë atë CD, sepse ne paguhemi që jemi këtu dhe të shohim se ata banorë janë duke vuajtur për shkak se e kanë bërë këtë peticion.

Kryesuesi – Ju llap topin e keni me vete dhe mund ta shikoni CD-në. Kërkesën ne e morëm nga z. Armend sot dhe unë propozoj që DI-ja, DMM-ja dhe ajo e pronës, të na sjellin një raport në mbledhjen e radhës. Nëse, vërtetë është usurpuar prona keqbërësit duhet të ndëshkohen maksimalisht.

Armend Rushiti – Pyeti se kush e merrë përgjegjësinë për raportet e dhëna nga DI-ja, dhe a mendoni se ai brenda natës e ka usurpuar pronën.

Kryesuesi – Përgjegjet se përgjegjësinë e marrin ata që e kanë pasë obligim.

Nazmi Gashi – Kërkoj që 2 Drejtoritë në mbledhjen e radhës të na sjellin një raport të detalizuar dhe propozoj që të formohet një Komision prej Kuvendit, për të verifikuar gjendjen në terren.

Kryesuesi - Kërkesa që erdhi sot, unë jam dakord që të trajtohet nga DI-ja, DMM-ja dhe DPUPK-ja, në mënyrë që të dijmë se cilat masa konkrete janë marrë.

Hysni Mjeku – Unë kam vërejtje në udhëheqjen e mbledhjes, kryesues përbaj Rregullores dhe fundi i fundit jo të flas një anëtar i Kuvendit 100 herë për një çështje. Problemi i Mazgitit, duhet të ndjehet si problem i të gjithë neve, këtu. Nëse, bëhet fjalë për degradim të tokës, apo uzurpimit jashtë vendimit të Kuvendit, unë jam për sanksione sepse ka shkelë dhe degradue pronën publike. Nëse, është ndotë ambienti jashtë parametrave të paraparë me ligj s'ka pardon këtu, sepse nuk mund të hudhen 3,000 banorë për interesat e një individi. Prandaj, ne duhet ta dijmë qartë se a kemi të bëjmë me ndotje të ambientit apo me uzurpim të pronës. Unë po e shohë se është me të dyjet, por inspeksioni duhet të dalë në vendin e ngjarjes dhe të na sjellë raport se në cilët parametra është shkelë prona publike dhe është ndotë ambienti. Nëse, janë tejkaluar parametrat, atëherë ne këtu duhet me debatue dhe vërtetë me i dhënë sanksion.

Lulzim Sadiku – Kryesues, ju jeni i njejtë me të gjithë të tjerët këtu dhe në njëfarë mënyre je më i dështuar se të tjerët, janë 50 vendime MAPL-ja që ti ka kthyë prapa. Thua, unë dhe nuk i lejon njerëzit kur e kanë qëllimin e mirë të diskutojnë. Unë kam me kërkue edhe prej Kryetarit që me bë ndryshim sepse 50 vendime janë kthyë prapa dhe ti je ai që e udhëheqë këtë Kuvend komunal. Prandaj, mos na ndërprefj fjalën kur ne kérkojmë diçka, krijo kushte për Asamblenë, e jo të thuash unë sepse ti je i barabartë me neve. Unë po flas në emrin tim se unë jam opozitë dhe dua të diskutoj për pikën e rendit të dtës. Mos u mundo me i fshehë të këqijat e këtij Kuvendi komunal dhe të kësaj Komune. Anëtarët e Kuvendit, mos i ndërprefj sepse nuk i keni zgjedhë ju, por janë ardhë me votën e qytetarëve dhe lejoni të punojnë për çështje me interes të qytetarëve.

Aziz Bici – Unë i kam 3 kërkesa dhe fjalën e kam për fshatin Plemetin, sepse ne jemi të shqetësuar rrëth ndërtimit të këtyre shtëpive në Plemetin. Unë kam bërë pyetje në një seancë kur ka qenë edhe vet Kryetari këtu, dhe pyetja ime ka qenë cili ishte roli i Kryetarit dhe Ekzekutivit komunal në këtë projekt dhe përgjegje nuk kemi pasë. Poashtu, a është e vërtetë se kemi banorë të ardhur nga Komunat tjera të Kosovës, nga shteti i Serbisë dhe Maqedonisë të cilët asnjëherë nuk kanë qenë banorë të Kosovës, që edhe për këtë pyetje nuk kemi pasë përgjegje. Përgjegja e vetme që unë e kam pasë prej Kryetarit ka qenë se donatorë janë Ministria e integrimeve dhe Bashkimi Evropian. Mendoj se këtë çështje duhet me trajtue seriozisht sepse përveç që ka pabarazi që e ndjejnë veten qytetarët ka edhe prapavijë. Prandaj, kam votuar kundër ndërtimit të rrugës që është votue më heret. Në fshatin Mazgit, te lagjja lartë atje “Currët” saktë te Idriz Rushiti, është i mbyllur kanalizimi dhe për çkado mbylljet. Edhe përkundër që janë njoftuar Drejtoritë përkatëse, nuk janë ndërmarrë masat dhe atje banorët kanë problem me mbyllje të kanalizimit. Shpresoj që kjo kërkesë e imja të merret seriozisht sepse e dijmë sa afër janë shtëpitë dhe i dijmë pasojat në rast se mbylljet kanalizimi. Tjetra, është rrëth ndërtimit të sheshit, jemi dëshmitarë se pas 9 javë, nuk është punuar asgjë në shesh, do të thotë në një sipërfaqe prej 1 ha, rrëth $9,000 \text{ m}^2$ që ka mundësi të punohet, përveç gjatë fushatës që janë shtruë disa m^2 dhe janë shtruar bukur shpejtë që do të thotë se kur punohet ka mundësi me ecë më shpejtë ky projekt. Pyetjet e mia janë: pse nuk punohet për çdo ditë, pse nuk është vendosë asnjë tabelë në vendin ku po punohet sheshi sepse ligji e parashehë në fillim dhe përfundim të hapësirës ku punohet të vendoset tabela (ku shkruhet emri i donatorit, emri i punëkryesit dhe emri i projektit). Për mua, është e çuditshme se automjetet e rënda të kësaj kompanie janë me regjistrim të huaj të shtetit serbë, fjala është për automjetet e rënda. Ne e dijmë se automjete të renda këtu kemi mjaft me regjistrimin tonë dhe paguhën edhe taksat komunale dhe ato tjerat që shihen.

Kryesuesi – Përgjegjet se për çështjen e kanalizimit është drejtori i DSHPE-së, ndërsa për sheshin të gjithë kemi pyet pse është vonue dhe kam marrë përgjegje se janë përcaktue pllakat të cilat janë duke ardhë. Të gjitha pyetjet regjistrohen dhe kur ju shkon procesverbali Ekzekutivit, do ta keni përgjegjen.

Naim Miftari – Sqaron rrëth kërkesës së z.Aziz Bici, lidhur me mbylljen e kanalizimit se nuk është e vërtetë, që nuk kemi ndërmarrë masa sepse para një javë e kam dërguar kompaninë e cila e ka bërë debllokimin e rrjetit të kanalizimit. Mirëpo, bashkë me inxhinjerat kemi ardhë në përfundim se aty duhet të intervenohet në një pjesë të atij kanalizimi, që aty mos të ketë më problem. Unë të kisha këshillue që informatat ti merrni më të sakta, e jo me folë fjalë që nuk qëndrojnë.

Aziz Bici – Këtu, po shihet se vetë po tregon që është e vërtetë sepse ai projekt është i imponuar moti, do të thotë se ajo qëndron se për çfarëdo bëhet mbyllja e kanalizimit dhe ju pas kaq kohe mos me interveneue për me bë zgjidhje të kësaj. Unë të kisha thënë tërhiqe atë fjalë sepse nuk paske të drejtë me thënë nuk është e vërtetë sepse është e vërtetë dhe ju merrni masa e mos shikoni vetëm me heqë problemin se u futëm në dimër dhe dimrit e keni më problem me punue. Për këtë arsyen kryeni punën më heret sepse keni mundësi.

Naim Miftari – Fjala ishte te debllokimi, unë thashë se te një pjesë e atij kanalizimi duhet me interveneue dhe unë nuk jam fajtor se në kohën e LDK-së, kanë futë aty gypa Ø 100.

Hysni Mjeku – Unë e përgëzoj Ministrinë e ambientit, që në këto ditë e ka bërë pastrimin e lumit Drenica, por mbetjet që kanë mbetë aty vërtetë, gjasojnë në një Hiroshimë dhe nuk e di përfaqësuesi i Kuvendit komunal, kush ka qenë me i përcjellë këto punime, çfarë mendimi ka dhënë për këtë firmë. Është fillimi i sezonës vjeshtore dhe nëse, këto mbetje inerte nuk largohen, besoj se fshatarët nuk mund ti kryejnë punimet e veta në këto ditë të vjeshtës. Prandaj, sugjeroj që një përfaqësues i Kuvendit komunal, i Ekzekutivit duhet të delë në vendin e ngjarjes të shohë se në çfarë gjendje i ka lënë punimet kjo firmë. Unë para kësaj seance kam këruar që në parkingun e fshatit Grabofc i Epërm, te xhamia të bëhen vijat e parkingut dhe nuk e di cila firmë e ka pasë për detyrë, ajo që i ka kryer punimet apo një tjetër dhe pse nuk është ndërmarrë që 2 muaj, asgjë në këtë drejtim. Ju lutem kryesues, ose ti vazhdojmë punimet e Kuvendit në mënyrë të rregulltë se po shohë se disa anëtarë jemi këtu në sallë dhe dalin pa pyetur fare. Kjo është absurde, sepse ose po dalim të gjithë po shkojmë ose po qëndrojmë këtu, të gjithë. Vërtetë, ne duhet ta kemi një gjuhë komunikuese institucionale më të mirë në mes veti. Kërkoi nga administrata të nxjerret një pasqyrë e vendimeve të cilat MAPL-ja, i ka kthyer deri më tanë me qëllim të funksionalitetit më të mirë të këtij Kuvendi.

Nazmi Gashi – Kërkoi që anëtarët e Kuvendit komunal të pajisen me kartela identifikimi dhe poashtu, ta kemi një varëse të rrobeve në sallën e Kuvendit komunal.

Kryesuesi – Ju, deri me dt.10, të gjithë duhet ti bëni fotografitë, në mënyrë që të përgatiten ID-të dhe e bëjmë panon.

Muhamed Mustafa – Komuna, vërtetë është e vërvshuar prej projekteve dhe punëve që po bëhen në të gjitha fshatrat, ashtu ndodhë edhe në fshatin Breznicë. Mirëpo, punët që po bëhen nga disa operatorë ekonomik në njëren anë punohet, ndërsa në anën tjetër prishet kështu ne në Breznicë e kemi një operator ekonomik i cili në 4 vende, rrugën kryesore e ka prerë rr.”Koskoviku” është për me u quditë se a i kryen punët projekt menaxheri qysh duhet, mbikqyrë, apo është çështje e specifikimit teknik të projektit, që është bërë. Unë kam një vërejtje shumë të madhe se nuk bëhet menaxhimi i mirë i projekteve ashtu si duhet. Në rr.Obiliq-Palaj është kënaqësi me kalue me i pa drunjët e mbjellur, por ata drunjë me pa se ku i kanë mbjellë, ata janë të destinuar me dështue sepse nuk rriten drunjët në gurë. Nëse, nuk është bërë specifikimi teknik i dosjes së tenderit qysh duhet me u ndërrue ata dhe aty dhe është hera e tretë që ndërrrohen ata drunjë andej. Kjo është para publike dhe duhet pasë kujdes, nëse nuk ndërrrohet dhei ata drunjë nuk bëhen atje.

Kryesuesi – Ne e patëm raportin 9 mujor financiar dhe keni mund me bë vërejtje dhe pyetje konkrete. Unë e di se është duke u punuar mjaft dhe aty ku ka bukë, ka edhe trosha, aty ku punohet ka edhe lëshime, por ju shikoni më shumë të mirat.

Aziz Bici – Fjala konkrete ishte rrëth drunjëve të mbjellur dhe nuk ishte fjala në përgjithësi te projektet që u thirre shikoni të mirat, e mos i shikoni vetëm këto. Ju duhet të falenderoheni për këtë që ne i ngritim si

çështje. Unë ju thashë për në anën tjetër ju e dini pse janë prishë ashtu, kanë fillue me u dëmtue drunjët apo me u prishë te rr."Llapi" dhe në shumë vende mungojnë. Inspektorët ose ata që janë kompetentë duhet të dalin dhe të bëjnë një raport se çka është duke u bërë dhe a është gjabit dikush për këtë çështje. Në rast se ne vazhdimisht japim para dhe mbjellim në pranverë, ndërsa në vjeshtë i prishim, nuk interesohemi për mirëmbajtje, kjo është papërgjegjësi.

Lulzim Sadiku - Për çështje të drunjëve e kam ngritë zérin shumë herë dhe është hera e tretë që janë ndarë mjetet në shumën prej 70,000-80,000 €, dhe kanë dështue. Ndoshta, për ty janë trosha, por është një shumë e buxhetit bukur e madhe e qytetarëve të saj. Dikush po thotë se po bëjmë politikë, dikush po thotë unë di, por ne po mundohemi me dhënë kontribut. Mendoj se nuk është troshë, sa është bërë financimi në ata drunjë edhe pse e kam bindjen se nuk do të mund t'iu qëndrojnë kushteve atmosferike në Kosovë. Unë kam thënë para 4 vjetë, se drunjët mund të jenë bregdetar dhe me klimën që kemi në Komunën dhe shtetin tonë nuk mund të përparojnë. Unë jam shumë i shqetësuar, shumë herë e kam ngritë zérin dhe kërkoj që kjo pyetje të jetë edhe në Këshillin e drejtoreve, se si me i ruajtë dhe me veprue me ata drunjë.

Mbledhja përfundoi në ora 14:42'

Bashk.prof për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri